

LASGUSH PORADECI
Gjuha e zjarrtë
(nga vëllimi “Ylli i zemrës”)

O gjuhë-e shentëruar, o mall me shpirtin plot.
O vetëtim' e qjellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
Si pikë lot e ndritur po ndrij në reze t' uaj,
Po ndrij e papandehur po qaj pak e nga pakë
Sepse prej botës s' uaj kam mbetur kaq i huaj...

Kam mbetur kaq i huaj, dh'i ndrydhur edh' i shkret!
Prej ligjëratës s' ate që më çudit, o zjarr!
Me gjuhëra prej flake ti djeg... ti flet... ti pret...
Do vi! Do të vi pranë mjerush e dyke vuar,
E flakën vraparake në kraha do t' a marr,
Posi kuvënd të shkruar do të t' a çik me duar.

O këng' e shentëruar, o verb i larë n'ar.
O zjarr që më përflakesh si yll vetëtimtar.
O fshehtësir' e ndezur në fill prej shkreptime.

Kur të këndojs me gojë, kur të kuptoj në kartë,
Posi një krahatur ti dhemb, o Gjuhë-e zjarrtë,
Posi kullim' i gjakut që rreh në zemër t' ime.

Ti ndrin në thelb të jetës si dritë-e përvëluar
O gjuhë-e zemrës s' ime, o mos-e-kuvënduar.

